VENDIM
Nr. 605, datë 17.10.2018

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E DREJTËSISË DHE DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE TE MINISTRIA E MBROJTJES, TË PRONËS NR. 98, ME EMËRTIM "GRUP DEPO (ISH-REPARTI USHTARAK NR. 5011)", ME VENDNDODHJE NË BRAR, TIRANË, DHE TË DISA SIPËRFAQEVE TRUALLI FUNKSIONAL DHE OBJEKTE, TË PRONËS NR. 109, ME EMËRTIM "SHA RIPARIM ARTILERIE", ME VENDNDODHJE NË BRAR, TIRANË, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR, DHE NË VENDIMIN NR. 495, DATË 10.6.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, si dhe PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 796, DATË 22.9.2015, TË NDRYSHUAR, NR. 807, DATË 30.9.2015, DHE NR. 355, DATË 29.4.2015

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 14 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Drejtësisë te Ministria e Mbrojtjes, të pronës nr. 98, me emërtim "Grup Depo (ish-Reparti Ushtarak nr. 5011)", me vendndodhje në Brar, Tiranë, dhe të disa sipërfaqeve truall funksional dhe objekte prej 11 754.2 (njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e katër pikë dy) m^2 dhe 13 236 (trembëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë) m^2, me sipërfaqe të përgjithshme prej 24 990.2 (njëzet e katër mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë pikë dy) m^2, pjesë të pronës nr. 109, me emërtim "SHA Riparim Artilerie", me vendndodhje në Brar, Tiranë, sipas planvendosjeve që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave te Ministria e Mbrojtjes, të sipërfaqes truall funksional dhe objekte prej 18 179 (tetëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë) m^2, pjesë e pronës nr. 109, me emërtim "SHA Riparim Artilerie", me vendndodhje në Brar, Tiranë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, të hiqen prona nr. 98, me emërtim "Grup Depo (ish-Reparti Ushtarak nr. 5011)", me vendndodhje në Brar, Tiranë, dhe sipërfaqet truall funksional dhe objekte prej 11 754.2 (njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e katër pikë dy) m^2 dhe 13 236 (trembëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë) m^2, me sipërfaqe të përgjithshme prej 24 990.2 (njëzet e katër mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë pikë dy) m^2, pjesë të pronës nr. 109, me emërtim "SHA Riparim Artilerie", me vendndodhje në Brar, Tiranë, dhe të shtohen në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes e që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar.

4. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, të hiqet sipërfaqja truall funksional dhe objekte prej 18 179 (tetëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë) m^2, pjesë e pronës nr. 109, me emërtim "SHA Riparim Artilerie", me vendndodhje në Brar, Tiranë, dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave paluajtshme shtetërore që i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes e që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar.

5. Në vendimin nr. 495, datë 10.6.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Në titull hiqen fjalët "... të disa objekteve e të një sipërfaqeje trualli funksional, brenda territorit të pronës nr. 109, me emërtim "SHA Riparim Artilerie", me vendndodhje në Brar, Tiranë ...";

b) Në pikat 1 e 2 hiqen fjalët "... të disa objekteve dhe të një sipërfaqeje trualli funksional, me sipërfaqe të përgjithshme (S1) prej 13 236 (trembëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë) m^2, brenda territorit të pronës

nr. 109, me emërtim "SHA Riparim Artilerie", me vendndodhje në Brar, Tiranë...".

6. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 796, datë 22.9.2015, "Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, të pronës nr. 98, me emërtim "Grup Depo (ish-Reparti Ushtarak nr. 5011)", me vendndodhje në Brar, Tiranë, për dhënien në përdorim të përkohshëm të disa objekteve dhe të një sipërfaqeje trualli funksional, brenda territorit të pronës nr. 6, me emërtim "Instituti Gjeografik i Ushtrisë", me vendndodhje në rrugën "Myslym Keta", Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar", të ndryshuar, nr. 807, datë 30.9.2015, "Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Kulturës te Ministria e Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, të objekteve dhe truallit funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 11 754.2 m², pjesë e pronës nr. 109, me emërtim "SHA Riparim Artilerie", me vendndodhje në Brar, Tiranë", dhe nr. 355, datë 29.4.2015, "Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, të një sipërfaqeje prej 18 179 m², pjesë e pronës nr. 109, me emërtim "SHA Riparim Artilerie", me vendndodhje në Brar, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar", shfuqizohen.

7. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Drejtësisë, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLAN RILEVIMI

Prona nr.109 (Riparim Artilerie,Sh.a.,Brarë, Tiranë), prona nr.98, Grup Depo (Ish.Rep.Ushtr. 5011, Brarë, Tiranë)
për kalim në administrim nga Ministria e Drejtësisë, DPA në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes

DREJTORI I IGJIU
N/Kol. Ark. FERDI HYRAJ

Rihartol
Topograf Ramiz HAXHIU

IDENTIFIKIMI I PASURISË

Zona Kadastrale 3426
Nr.Pasurisë_____Vol.___Fq_____
Indeksi i Hartës K-34-88-(220-D) .
Shkalla 1: 2500
Adresa e pasurisë Tiranë
Q/F Brarë, Tufinë, Komuna Dajt
Pronari :
Ministria e Mbrojtjes, Brigada Logjistike
kalues me përgjegjësi administrimi Ministrisë së Drejtësisë,TKOPAP,DPA

Shtator 2018

Prona nr.98 = 18702 m² ,sip. që kalon nga MD për Ministrinë e Mbrojtjes, bashkë me objektet me nr.2,3,4,5,6,8,10,11,12,13,14, 15,16,17,18,19,20.

Prona nr.109
Sip S1 = 24990.2 m² sip. që kalon nga MD për Ministrinë e Mbrojtjes, bashkë me objektet me nr. 16, 17, 18 ,19, 20, 27, 28, 28/1, 29, 30, 31 dhe 32

Sip S2 = 18179 m2 sip. që kalon nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për Ministrinë e Mbrojtjes, bashkë me objektet 6,7,8,9,10,11,12,14

Shënim-Ky plan rilevimi u hartua bazuar në dokumentacionin hartografik të marrë në arkivin e IGJIU.

PLAN RILEVIMI

Prona nr.98 "Grup Depo, Ish.Rep.Usht. 5011", Brarë, Tiranë

për kalim në administrim nga Ministria e Drejtësisë në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes

DREJTORI I IGJIU
N/Kol. Ark. FERDI **HYRAJ**

Rihartoi
Topograf Ramiz HAXHIU

IDENTIFIKIMI I PASURISË

Zona Kadastrale 3426
Nr.Pasurisë_____Vol.__Fq____
Indeksi i Hartës K-34-88-(220-D) .
Shkalla 1: 2500
Adresa e pasurisë Tiranë
Q/F Brarë, Tufinë, Komuna Dajt
Pronari :
Ministria e Mbrojtjes, Brigada Logjistike
kaluar ne pergjegjësi administrimi Ministrisë së Drejtësisë,TKOPAP,DPA

Shtator 2018

Prona nr.98 = 18 702 m² sip. që kalon nga MD për Ministrinë e Mbrojtjes, bashkë me objektet me nr.2,3,4,5,6,8,10,11,12,13,14, 15,16,17,18,19,20.



Shënim-Ky plan rilevimi u hartua bazuar në dokumentacionin hartografik të marrë në arkivin e IGJIU.

PLAN RILEVIMI

Prona nr.109 "Riparim Artilerie",Sh.a.,Brarë, Tiranë
për kalim në administrim nga Ministria e Drejtësisë, DPA në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes

DREJTORI I IGJIU
N/Kol. Ark. FERDI **HYRAJ**

Rihartoi
Topograf Ramiz HAXHIU

IDENTIFIKIMI I PASURISË

Zona Kadastrale 3426
Nr.Pasurisë_____ Vol.___ Fq.____
Indeksi i Hartës K-34-88-(220-D) .
Shkalla 1: 2500
Adresa e pasurisë Tiranë
Q/F Brarë, Tufinë, Komuna Dajt
Pronari :
Ministria e Mbrojtjes, Brigada Logjistike
kaluar ne pergjegjesi administrimi Ministrisë së Drejtësisë,TKOPAP,DPA

Shtator 2018

Prona nr.109

Sip S1 = 24 990.2 m² sip. që kalon nga MD për Ministrinë e Mbrojtjes, bashkë me objektet me nr. 16, 17, 18 ,19, 20, 27, 28, 28/1, 29, 30, 31 dhe 32

Sip S2 = 18 179 m2 sip. që kalon nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për Ministrinë e Mbrojtjes, bashkë me objektet 6,7,8,9,10,11,12,14

Sip. përgjithshme për kalim në administrim MM = 43 169.2m2

Shënim-Ky plan rilevimi u hartua bazuar në dokumentacionin hartografik të marrë në arkivin e IGJIU.